



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



**EKSTRAKT**

**i procesverbalit nga sesioni i dëgjimit publik me qytetarë, mbajtur më 08.06.2022, duke filluar në orën 10:00.**

Sesionin e dëgjimit publik me qytetarë e hapi znj. Luljeta Selimi, U.D e shefit të Sektorit të Kuvendit.

Fillimisht të pranishmit i përshëndeti Përparim Rama, kryetar i Komunës njiherit duke iu uruar mirseardhje në këtë debat publik, i cili tha se me diskutimet e përbashkëta, angazhimet e përbashkëta do të mundohemi për transformimin e kryeqytetit për të mirën e të gjithë qytetarëve.

**Alban Zogaj**, nënkryetar i Komunës hapi debatin.

**Përfaqësuesi i Bashkësisë Lokale - Llukar** i parashtrori dy kërkesa:

Kërkoj që rrjetin e energjisë elektrike me e vazhduar për në zonat e Gollakut, pra me e filluar nga aty ku ka mbetur qe ky rrjet ka ardhur nga Komuna e Podujevës, dhe te vazhdoi në keto zona.

Gjithashtu kërkoj që fshatrat e zonës së Gollakut të lidhen me rrjetin e ujësjetllësit e që furnizimi me ujë do të ishte më se i domosdoshëm për banorët e këtyre fshatrave.

**Qytetarja** nga rruga "Bledi 2", rruga për Gërmi rendi i tretë i shtëpive,tha se në kohën e ish kryetarit te Komunes Ismet Beqiri është bërë një lëshim i madh ai ka lejuar që midis rrugës me u ndërtuar shtëpia dhe ne nuk kemi qasje në asnjë formë për hyrje dhe dalje në pronën tonë. Kërkoj nga kryetari që te merren masa për zgjidhjen e këtij problemi.

**Shaban Qarreti**, qytetar tha se më se 40 vjet jemi aty ne rrugen "Bledi 2" dhe deri me sot ne kemi pengesa për qasje në pronën tonë, andaj kërkoj nga kryetari që të marr hapa konkret për zgjidhjen e këtij problemi.

**Muharrem Hundozi**, qytetar nga lagja "Emshir" tha se në dy ngastra rreth prockës së Matit, me një gjatsi prej 130 m, me nr. 7637/3 dhe 7639/20, nuk më lejohet e drejta e shfrytëzimit te prones time, andaj kerkoj nga kryetari që të më bëhet një zgjidhje.

**Ismet Haziri**, përfaqësuesi i Bashkësisë së VII Lokale tha se po i bëjë ftesë publike kryetarit të Komunës që të na vizitoj një ditë në shkollën e Matiqanit së bashku me ekzekutivin dhe ti paraqesim të gjitha problemet, shqetësimet e banorëve të asaj zone.

**Osman Vitia**, përfaqësuesi i Bashkësisë Lokale VIII Prishtinë tha se në Tauk Bashqë janë disa plepa më se gjashtëdhjetë vjeçar, dhe janë në një gjendje jo të mirë mos të them alarmante por që donë një trajtim sepse Tauk Bashqen e shëtisin shumë qytetarët zakonisht pas dite, ju kisha lutur ti trajtoni ata plepa.

Po ashtu në këtë park të qytetit ka ujëra të zeza në 2-3 vende kundërmojnë dhe ka ankesa të shumta të qytetarëve që nuk po hiqen ato.

Gjithashtu pyes se kur do të filloi ndërtimi i një shkolle në lagjen Sofalia.

**Ali Vitia**, banor i lagjes “Veternik”, rruga “Nekibe Kelmendi” parashtroi dy kërkesa:

Rruga “Nekibe Kelmendi” është në gjendje të mjerueshme nuk ka kanalizim, nuk ka ndriçim, ka qarkullim shumë të madh të mauneve, të automjeteve dhe fëmijët tanë po rrezikohen për çdo ditë dhe kishte qenë mirë me na e bërë një zgjidhje.

Po ashtu dua ta qfaq një problemi personal për ngastrat kadastrale 1709, 1710, 1711 dhe 1712 apo shprehur me numra 174 ari që nga viti 2004 e deri më sot kanë mbetur të bllokuara nga planifikimi i unazës së brendshme, andaj kërkojmë një zgjidhje.

**Ramë Cakiqi**, qytetar tha se kam punuar më se 20 vjet në Parkun e Qytetit me një lokal, leje kam marr prej Drejtorisë së Shërbimeve Publike, tash këtë vit është formuar edhe Drejtoria e Parqeve edhe nuk marr leje as prej Drejtorisë së Shërbimeve Publike e as prej Drejtorisë së Parqeve, andaj kërkoj të di se kujt duhet ti drejtohem tani.

**Endrit Aliu**, qytetar tha se jam nga shtypshkronja “Grafikal Hos” dhe kam ardhur sot për të vetmin qëllim me e propozuar një projekt i cili ndërlidhet me arsim për Komunën e Prishtinës, përkatësisht për shkollën teknike “28 Nëntori”, shkollë profesionale, projekt i cili i ndihmon në avancimin dhe shkollimin profesional nxënësit e teknikës, kështu që lidhur me këtë projekt do të diskutoi edhe edhe me drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit me të cilën do ti diskutojmë detajet.

**Aziz Pacolli** – ish asamblist i KK Prishtinë tha se asambleja e vitit 2012 e ka votuar Planin rregullues të zonës ekonomike, e në vitin 2013 edhe Planin Zhvillimor Urban. Tash kjo është kërkesë e gjithë rajonit, e gjithë Zonës ekonomike që të kthehet koeficienti ose të kthehen koeficientët sipas planit rregullues, por edhe sipas PZHU-së me të cilën na e ka marr votën si asamblist neve.

**Nezir Bunjaku**, qytetar tha se Parku i qytetit nuk është duke u trajtuar ashtu si duhet, rrugicat janë tejet të dëmtuara, po ashtu edhe trajtimi i drunjëve nuk bëhet ashtu si duhet. Në këtë hapësirë rrezikohet siguria e qytetarëve e në veqanti e fëmijëve nga qent endacak që partaqesin një rrezikshmëri të madhe, andaj kisha kërkuar nga kryetari që të merreni pak me parkun, sepse parku është hijeshia e qytetit.

**Ejup Gashi**, kryetar i Bashkësisë Lokale të fshatit Mramor tha se ne kemi shumë kërkesa që i dorëzojmë për çdo vit, ku dhe në këtë Bashkësi Lokale graviton Busia dhe Zllashi. Ne kërkesat i dorëzojmë për çdo vit kalendarik dhe halle kemi shumë, po njëri ndër hallet më të mëdha është mungesa e rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit, kështu që është mirë që kërkesat tona kur ti dërgojmë në Komunë të na kthehen përgjigja me projektet e parapara për vitin kalendarik.

**Avni Pestisha**, përfaqësues i lagjes "Sinidollo", Bërrnicë e Epërme tha se kemi bërë kërkesë në Drejtorinë e Pronës për gjetjen e një prone të mundshme për vendosjen e varrezave, pasi që aty ku janë sot varrezat nuk ka vend për varre. Po ashtu kërkojmë që të bëhet ndriqimi i këtyre lagjeve dhe sinjalizimi i rrugëve për shkak që automjetet me shpejtësi të madhe po i rrezikojn edhe banorët e asaj ane.

**Selatin Gashi**, përfaqësues i lagjes "Qendra" tha se prej 'Grand' hotelit deri tek ish -Kino "Rinia 1" është një numër shumë i madh i banesave të cilat janë të mbuluar ende me material prej azbesti, që me të vërtet paraqet një rrezik të madh për shëndetin e njerzve dhe kërkoi që të hiqen prej përdorimit. Po ashtu kërkoi që drunjët plepa të zëvendsohen me drunj të ri, pasi që plepi është një dru i cili rrënjët e tij janë më sipërfaqësore dhe nuk janë të përshtatshëm për infrastrukturën aty për rreth tij.

**Një qytetar** banor afër rrugë "Sali Nivica" kërkoi nga Komuna që të shihet mundësia e zgjerimit të kësaj rruge, pasi që rruga ekzistuese është shumë e ngushtë dhe pothuajse pjesa dërmuese e saj është në pronën private, kështu që lidhur me këtë rast tha se, ne në shenjë humanitetit nuk e kemi bllokuar këtë rrugë asnjëherë edhe pse kalon përmes pronës tonë.

**Bedri Hajzeri**, përfaqësues i Bashkësisë Lokale të fshatit Koliqit tha se këtij lokaliteti i mungon transporti publik, edhe përkundë kërkesave që i kemi bërë vite me radhë nuk kanë gjetur zbatim. Po ashtu janë dy rrugë njëra në lagjen Hajdaraj mirëpo ajo gjatë projektimit në buxhet ka figuruar një krah i rrugës, dua të dijë se a është edhe në tender krahu tjetër i rrugës. Rruga tjetër Koliq - Keqekollë që është një projekt i lënë në gjysmë, është punuar një pjesë e saj dhe pjesa tjetër ka mbete në gjysmë ku projekti është i gatshëm. Kërkoj nga ju drejtor që me rishikim të buxhetit të shikohet mundësia që të futet në projekt buxhet. Po ashtu kërkojmë që të gjitha ato rrugë të shkurtra të cilat lidhen me rrugën kryesore të bëhet ndërtimi i tyre.

Kërkesë e kahershme është edhe kthimi i referentit në vendin e punës në Bashkësinë lokale.

**Flutra Zymi**, qytetare tha se jemi duke folur për infrastrukturë, për trotuare për ajër dhe për hapësirë publike që janë gjëra esenciale dhe kjo vjen prej mungesës së kapaciteteve brenda në Komunë dhe koordinimet me ministritë përkatëse. Pse të lejohen ndërtime pa infrastrukturë të Komunës së pari pa qenë rruga, pa qenë rryma, pa qenë uji, pa qenë kanalizimi, shkolla, ambulanta, e të gjitha të tjera, pra kisha kërkuar që mos të bëhen planifikime pa analiza pa statistika, pra ju kisha lutur që mos bëni ndryshime pa bërë analizë dhe hulumtime të mirëfillta.

**Avdi Aliu**, përfaqësues i fshatit Keqekollë tha se fshati Keqekollë ka diku 12 lagje që shtrihen në thellësi të rrugës së magjistrale që të qon në kufi dhe janë të gjitha gati të pa kalueshme, ku ka lagje që është 4 km nga rruga magjistrale dhe sidomos dimrit ato familje janë totalisht të bllokuara dhe në mungesë të rrugës, mbeturinat mbesin pa u mbledhur nga kompania e mbeturinave. Po ashtu problem tjetër janë edhe shtyllat elektrike tepër të vjetruara të cilat shkaktojnë ndërprerjen e energjisë elektrike. Shqetësuese në këtë zonë është edhe prerja ilegale e pyejeve, mungesa e mjekut familjar e që kërkojmë që mjeku familjar të jet në vendin e punës për gjatë tërë javës. Gjithashtu kisha kërkuar nga Drejtoria e Kulturës që për projektin “Memoriali në Prapashticë” ka vazhduar me mbrojtjen e shtëpisë së Mulla Adem Keqekollës që është futur në mbrojtje por ajo shtëpi është në shkatërrim e sipër, pra kërkoj nga kjo drejtori që të merret me këtë çështje është memoriali ku është bërë masakra në vitin 1921.

**Përfaqësues** i Bashkësisë Lokale nr.5 në qytet, gjegjësisht lagja e “Veternikut”, ku ka mbi 10,000 qytetarë nuk e ka asnjë shkollë, nuk e ka asnjë shtëpi shëndeti dhe në fund asnjë çerdhe të fëmijëve. Kërkesat e Bashkësisë Lokale prej vitit 2012 janë të panumërta të drejtuara drejtorive përkatëse, të gjitha premtimet 11 vjeçare deri mesot asnjë herë nuk janë marrë parasysh. Nxënësit e asaj lagje barten me autobus privat për në shkollat tjera në qytet, kështu që asnjë asamblist kurr nuk ju është drejtuar kësaj bashkësie lokale për ti pyetur për hallet dhe dertet e asaj lagjeje me përjashtim muajin e fundit para votimeve.

**Kadri Sokoli**, qytetar tha se kam një pronë në lagjen “Tophane” shtëpi tre katëshe, kam ardhur për pushime rastësisht dhe kam parë që kanë filluar ndërtime aty mu në shtëpinë time është themeli i ri nga firma “Tregtia”. Kisha kërkuar nga Komuna të merret ndonjë masë në parandalimin e kësaj pasi që konsideroi se është tejet sheqetësuese.

**Baki Gashi**, qytetar tha se jetoj në lagjen “Dardania” ku dhe kam disa halle. Jetoj aty Kurrizit dhe ka mëse 20 vjet nuk kemi ndriqim, po ashtu largimi i terracave të bëhet njëjt për të gjithë, gjithashtu shkallët e objektit po thyhen dhe po destinohen për lokale të ndryshme. Kisha kërkuar që aty ku jam duke banuar të hiqet një bli i cili është i vjetër dhe paraqet rrezik, si dhe si qendron qështja rreth dezinfektimit që nuk po kryhet që sa kohë.

**Albert Bahtiri**, banor i lagjes “Qëndresa” tha se në këtë lagje nuk kemi shkollë, nuk kemi qerdhe, nuk kemi qendër të mjekësisë familjare, nuk ka terene sportive nuk ka parqe, kurdihet se kjo lagje paguan tatimin në pronë, andaj kërkojmë prej Komunës që të ketë investime edhe në atë pjesë. Po ashtu në lagjen “Qafa” rruga “UÇK”, është një objekt privat banesor i cili ka fillu me u ndertu nga viti 2008/09 objekti nuk është përfunduar asnjëher, banorët të cilët kanë pas prona aty janë vendos shkëlq e shko sepse nuk kanë pasur zgjidhje tejeter. Lidhur me këtë gjendje kërkoj një përgjigje.

**Violeta Hasani**, kryetare e Komitetit lokale për siguri publike, zona qendër, ngriti një shqetësim rreth shaktimit të zhurmës së kafiterive sidomos për kafiteritë në rrugën “Rexhep Luci” edhe “Fahmi Agani”, ku ju pamundësohet qytetarëve jetesa për të pasë një jetë

normale. Falënderoi drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit me të cilët unë mendoj që janë shtylla kryesore për komunitetin, sepse vazhdimit janë në bashkëpunim me ne.

**Nezir Rama**, banor i lagjës “Kodra e Trimave” tha se sa i përket kontributit të dhënë, kjo lagje njihet edhe si lagja e qëndresë, pra kur ne veq e dimë se ka pas rezistencë aty, Nuhi Berisha me shokë, Ismet Krasniqi heronjë kombëtar, bile me pasë një lapidar diku ku ata ti nderojmë si lagje. Në këtë lagje nuk kemi shkollë të mesme, nuk kemi shtëpi të kulturës. Në parkun e Arbërisë staza e cila është prej gome ka filluar të shkatërrohet, po ashtu është kërkesë e banorëve që të parashihet koeficienti i lartë i ndërtimit.

**Shqipe Shkodra**, qytetare tha se jetoj në qendër në lagjen më të zhurshme po mendoj në Prishtinë, pra kalon ora 23 apo 24 dhe zhurma e muzikës nuk ndalet. Gjelbrimi pran trotuareve është **betonizuar** dhe i kan vendos karriket, andaj kërkojm që mundësisht të na kthehet ai gjelbrim ku dhe është ngushtuar qasja, hyrja në banesë, nuk e kemi lirinë në hyrje dalje.

**Adnan Mustafa**, banor i lagjës “Bregu i Diellit” ngriti një shqetësim rreth ndrrimit të adresave i cili tha se nëse ndërrohet emri i rrugës pse të ndërrohet adresa-numrat e objekteve dhe nuk po dihet se qka është problemi, e kjo nuk është në rregull.

**Ilir Jakupi**, qytetar tha se duke pasur parasysh investimet të cilat bëhen në shumë projekte e të cila projekte nuk realizohen ashtu si duhet, për arsye se nuk ka kapacitete dhe sistem të mirëfillt të menaxhimit të investimeve. Konsideroi se zhurma dhe pluhuri janë dy pika kryesore të krejt problematikave, e që për me e ataku zhurmën duhesh të jesh shumë i menqur, pra ajo mund të na vjen prej bagerave, betonierkave si dhe prej motorrave të cilët e kalojnë mesataren e zhurmës së lejuar.

**Nezir Buzaku**, banor i lagjës së spitalit, më konkretisht rruga “Vëllezërit Bytyqi” ngriti një shqetësim rreth kundërmimit të prroit i cili tha se ky prrua vjen nga Zllatari dhe kalon përgjatë pronës time dhe jeta është bërë e padurueshme aty. Kërkoj të dij se a është kryer projekti i rrugës A dhe kur do të filloj dhe si do të kompenzohet pronat që do të merren nga rruga A. Problem tjetër janë edhe qent endacak që paraqesin një rrezik të madh dhe a do të merret ndonjë masë në parandalimin e këtij rreziku.

**Kryetar i Bashkësisë lokale “Qendra”**, i parashtroi këto kërkesa:

- A ka mundësi që të bëhet zgjerimi i zyrës së kësaj bashkësie, pasi që për momentin është vetëm me 3 m<sup>2</sup>, ku aty punojnë 4 zyrtarë.
- Në Qendrën kryesore të Mjekësisë Familjare, në objektin e Pediatriisë dhe Gjinekologjisë, aty kanë nevojë më e rregulluar një ashensor për gratë shtatëzëna dhe për personat me nevoja të veqanta.
- Në rrugën “Hajdar Dushi”, kompania KE, e cila ka bërë shtrirjen e gypave të Termkosit, ka disa muaj që vetëm i kanë mbuluar me zhavorr e që në masë e ka vështersuar lëvizjen në rrugë.

- Në këtë BL e kemi vetëm një fushë sporti e cila gjendet të Qafa kurse kemi nevojë edhe për 3 të tilla.
- Si do të vepronet më garazhet në rrugën "Sylejman Vokshi", janë garazhe shumë të vjetra.
- Lëvizjet me trotinet po paraqesin rrezik nëpër sheshe ne e dimë që në shesh është shenja e ndalimit për qarkullimin me biçikleta, por çfarë të bëjmë me trotinetet që lëviyin me një shpejtësi shumë të madhe sidomos gjatë kohës së mbrëmjes.
- Pse mos ta emërtojmë ndonjë rrugë me emër të ndonjë aktivisti që ka dhënë një kontribut të madh në mesin ton, e po emërtojmë rrugë siq janë rruga Stamboll, Vjena, Opoja etj.

**Masar Dushi**, prof. arkitekt dhe urbanist tha se un si qytetar në lagjen "Arbëria 3", kamë një kërkesë që aty të "Rrokuzina" është një fyt i krijuar prej qytetarëve, i krijuar më u lidh drejtë me zonën me qendrën të 21-shi. Si arkitekt propozoj nëse kanë mundësi të krijohet një urë improvizuese që edhe ata qytetar që nuk janë pak të kenë një dinjitet gjatë kalimit në atë pjesë. Nuk e di sa është buxheti sot besoj do të jetë mbi njëqind milion euro, që është për keqardhje që Komuna e Prishtinës me mbi gjysmë milioni banor, kuptimin operativ të fjalës ende spo mundemi më arrit me e pasur një buxhet mbi njëqind milion euro. Prishtina duhet ta përdorë ligjin e vetë mbi Prishtinën, të e zgjerojë në kompetenca të veta të ketë rregullore me autorizim që vetë të e zgjedhë çështjen e OSHP-së.

**Bedri Hajzeri**, qytetar ngriti një shqetësim për prishjen e rendit dhe qetësisë publike që behët nga subjektet hoteliere në rrugë të ndryshme të Prishtinës, duke filluar prej rrugës "Fehmi Agani", "2 Korriku", "Rexhep Luci", rruga "B", rruga "C", të Xhambazët etj, lokale të cilat nuk operojnë në përputhje me Rregulloren për dhënien e lejeve për afarizëm hotelier.

**Kaltrina Bujupaj**, nga organizata "Ec Më Ndryshe", ngriti disa probleme siq janë mungesa e tndriçimit publik, uzurpimi i trotuareve, dëponitë ilegale, mirëmbajtjet e kontejnerëve, gropat në rrugë e tjera, pra njëra prej komunave më të cilën kemi nisur më dërguar kërkesa të tilla së bashku më fotografitë edhe me emrin e rrugëve është edhe Komuna e Prishtinës, kërkoj që ky bashkëpunim me vazhduar edhe më tutje.

**Një qytetar** tha se para se të shkohet te restoranti në Bërnice të Epërme është një burim i ujit i cili dita ditës veq është duke u shkatërruar. Kërkoi nga Komuna që të intervenohet dhe të ndërtohet ajo qeshme që mos të shkatërron.

**Një qytetar** nga lagja e poshtme e Bardhoshit tha se ka më shumë se 15 vjet që kemi bërë kërkesë për ndërtimin e një shkollë fillore deri në klasën e pestë dhe këta fëmijë mësimin e vijojnë në shkollën "Andon Zako Çajupi".

Po ashtu kemi kërkuar që të bëhet rrethoja e varrezave, asfaltimi i disa rrugicave që lidhen me rrugën kryesore, si dhe rrjetin e kanalizimit.

**Fadil Beka**, qytetar nga lagja "Bajram Bahtiri" tha se ajo lagje e ka një problem që 20 vjet me zhurmë të motor sharrave, jemi ankua, kemi bërë petition dhe deri më sot nuk është marrë asnjë hap për zgjidhjen e këtij problemi.

**Një qytetar** tha se vetëm dua ta dijë prej stafit të kryesisë së Komunës dhe prej Kryetarit a ka mundësi vetëm më e marrë si premtim që më realizohet kërkesa e aplikimit për qatë banesë.

**Një qytetar** tha se në zonat e Gollakut përveq që po shkatrohen pyejet atje ka hy betoni, kanë hyrë betonjerkat në gollak nuk ka te ndalur. Po ashtu vendosja e policve të shtrir në rrugë dukshëm do ta ngadalsonte shpejtësin e automjeteve dhe pikrisht një vendosje e tillë do të ishte më se e nevojshme të jetë edhe në rrugën të Xhamia e Llapit. Sa i përket ndriqimit publik tha se mendoj që ka ardhur koha që ndriçimi publik të bëhet me ngjyra të ngrohta e jo të bardha.

Lidhur me kërkesat, pyetjet, sugjerimet dhe vërejtjet e parashtruara nga qytetarët, përgjigje dhe sqarime të nevojshme dhan: Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Mimoza Sylejmani, drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Florian Dushi, drejtor i Drejtorisë së Inspektionit, Përparim Rama, kryetar i Komunës, Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Doruntina Maloku, drejtore e Drejtorisë së Pronës, Donjeta Sahatçiu, nënkryetare e Komunës, Besianë Musmurati, drejtore e Drejtorisë së Arsimit, Bersant Beka, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit.

**Alban Zogaj**, nënkryetar i falënderoi të gjithë qytetarët pjesëmarrës në këtë sesion të dëgjimit publik.

Sesioni i dëgjimit publik përfundoi në ora 14:55.

**Procesmbajtësi**  
**Zijadin Gashi**

**Kryesues i sesionit të dëgjimit publik**  
**Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës**